



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:170661
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05625978

Cap.nr.1777/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, nga gjyqtarja individuale Naime Ahmeti, në çështjen përmbartimore të kreditorit R.B.K., me seli në Prishtinë, Rr. "...", nr..., kundër debitorëve K.Ç. nga Peja, Rr. "...", nr..., L.M. nga fshati R., Komuna e Pejës dhe Sh.D. nga Peja, Rr. "...", me bazë juridike kthim i kredisë, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorës së parë, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, Ep.nr.287/21 të datës 06.09.2023, me datë 26.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e debitorës K.Ç. nga Peja, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, Ep.nr.287/21 i datës 06.09.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar Ep.nr.287/21 të datës 06.09.2023, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorës K.Ç. nga Peja, rr. ..., nr..., i parashtruar kundër urdhrorit të përmbartuesit privat Blerim Baloku në Pejë, P.nr.821/21 të datës 28.07.2021.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitorja e parë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta pranoj si të bazuar ankesën e debitorës, të prish aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë, Ep.nr.287/21 të datës 06.09.2023, të pranohet si i bazuar prapësimi i debitorës dhe të refuzohet si i palejuar urdhri përmbartimor ose lënda të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar kreditori duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që Gjykata e Apelit, ankesën e debitorës ta refuzoj si të pabazuar dhe aktvendimin Ep.nr.287/21 të datës 06.09.2023, ta vërtetoj.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorëve në bazë të dokumentit përmbartues-marrëveshjes mbi kredinë personale, marrëveshjen mbi pengun si dhe konfirmimin mbi regjistrimin e pengut R-20170113-116, të regjistruar pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë-Zyra për Regjistrimin e Pengut. Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin e kërkuar me urdhrin përmbartimor P.nr.282/21 të datës 23.04.2021, ndaj të cilit urdhër debitorja e parë ka paraqitur prapësim me datën 30.06.2021, ndërsa kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datën 05.07.2021. Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimit dhe përgjigjes në prapësim vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin duke u bazuar marrëveshjen mbi kredinë personale, marrëveshjen mbi pengun si dhe konfirmimin mbi regjistrimin e pengut R-20170113-116, të regjistruar pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë-Zyra për Regjistrimin e Pengut. Nga kjo rezulton se përmbartuesi privat si dhe gjykata e shkallës së parë drejtë kanë vepruar kur kanë lejuar përmbartimin gjegjësisht kanë refuzuar prapësimin, ngase sipas ligjit përmbartimi lejohet në bazë të dokumentit përmbartimor dhe dokumentit të besueshëm. Në rastin konkret kemi të bëjmë me marrëveshjen mbi pengun të regjistruar në regjistrin zyrtar sipas ligjit siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 22, paragrafi 1.7.a të Ligjit nr.05/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e LPP-së, se dokument përmbartues është: *“kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut”*, e që në rastin konkret janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore për lejimin e përmbartimit.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 209 par 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Cap.nr.1777/23, me datë 26.04.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti